

Dhjetë rregullat e lojës për prindërit

Për ta mbajtur të gjallë dëshirën e të luajturit tek fëmija juaj dhe për të qenë ju si prindër partnerë të mirë të lojës me fëmijën tuaj, rregullat/udhëzimet në vazhdim mundë të ju ndihmojnë.



© suze/photocase.de

1. Jepni fëmijës tuaj kohë dhe qetësi të mjaftueshme për të luajtur.

Mos e ndërprisni pa nevojë fëmijën duke luajtur. Jepni fëmijës mundësi të mjaftueshme për të luajtur vetëm. Mos planifikoni të luani me fëmijën kur e keni kalendarin e termineve të stërm-bushur.

2. Vëzhgojeni fëmijën tuaj duke luajtur.

Ndërhyni vetëm atëher kur ka nevojë për ndonjë sygjërim, inkurajim apo ka nevojë për vëmendjen tuaj. Mundohuni të gjëni se çka është duke i interesuar apo çka është duke e prekur emocionalisht.

3. Tregoni interesim serioz për lojën e fëmijës tuaj.

Mos e anashkaloni në asnjë mënyrë dëshirën e fëmijës për të ju shpjeguar diçka apo shikuar veprat e tij të lojës. Tregoni simpati për atë që është duke e bërë.

4. Mos e kritikoni dhe përmirësoni fëmijën tuaj gjatë lojës.

Mos ndërhyri gjatë lojës së fëmijës, duke u munduar t'i tregoni se si duhet të bëhet kjo ose ajo. Jepni fëmijës kohë dhe mundësi që gjërat të i bëjë dhe të i gjejë sipas mënyrës së vet. Mendimi juaj lidhur me rregullimin, pastërtinë, bukurinë, çka është e drejtë dhe jo e drejtë nuk është (ende) i njëjtë me mendimin e fëmijës tuaj. Prandaj besoni në fëmijën tuaj dhe në zhvillimin e tij.

5. Mos e izoloni fëmijën në dhomën e tij.

Merreni fëmijën tuaj afër vetes, që të mësojë nga ju, që të luajë me ju. Mos e dërgoni në dhomë të luaj nëse nuk ka dëshirë të rrijë vetëm dhe i izoluar. Ndjenja e sigurisë dhe besueshmërisë i ndihmonë më vonë për të luajtur mirë vetëm dhe me fëmijët tjerë. Integroni fëmijën tuaj në punët e amvisrisë (pastrim, qerim, grirje, varja e rrobave etj.).

6. Kërkoni mundësitë që fëmija juaj të luaj së bashku me fëmijët tjerë.

Shikoni që fëmija juaj të luaj me fëmijët e lagjes, ftoni fëmijë në shtëpinë tuaj për të luajtur, regjistroni fëmijën në ndonjë grup të lojës. Shkoni me fëmijën tuaj në parkun e lojrave, në mal. 1 ose 2 vite para se të fillojë parashkollorja keni mundësinë ta regjistroni fëmijën tuaj në Grupin e Lojës në vendin ku ju banoni. Mundësojani fëmijës tuaj pjesmarrjen në të, në këtë mënyrë ia lehtësoni shumë fillimin në parashkollorë.

7. Kushtoni kohë fëmijës, ndërmerri diçka së bashku.

Fëmija juaj duhet të ketë kohë të mjaftueshme që të luajë vetëm. Mirëpo studimet e fundit tregojnë që fëmijët dinë të luajnë më mirë nëse prindërit si shembull ua tregojnë/shpjegojnë gjërat, luajnë me ta dhe i motivojnë ata në rast dështimi.

8. Mos i jepni fëmijës shumë lojra përnjëherë.

Ndërroni lojrat e fëmijës ndonjëherë. Lojrat e shtrejta janë të panevojshme. Gjërat e përditshmërisë janë shumëherë më interesante për fëmijën.

9. Mos e llastoni fëmijën, dhe mos ia largoni të gjitha vështirësitë.

Mos u bëni për fëmijën tuaj artist për argëtim, sepse kështu mundë të bëhet shikues pasiv!

Lereni fëmijën ndonjëherë që të mërzhitet, në këtë mënyrë ai krijon fantazi dhe kreativitet që të luajë. Poashtu mos i merrni përsipër që të ia largoni vështirësitë nga dora. Lereni fëmijën ta zbu-
lojë vetëm se si duhet të veprojë. Në këtë mënyrë ai e bën përvojën e vet e cila i ndihmonë që ta përballojë zhgënjimin dhe dështimin. Kështu mësohet të përballët me ndjenjën e dëshpërimit. Me rëndësi është që fëmija e privonë ndjenjën e suksesit dhe krenarisë, që ka qenë në gjendje të zgjidh dhe të arrijë diçka vetëm.

9. Mos e teproni me shqestësim për sigurinë dhe shëndetin e fëmijës.

Lereni fëmijën t'i provojë gjërat sa më shumë, lereni fëmijën të i bëjë gjërat vetëm. Sa më shumë që i rrini mbi kokë dhe mundoheni të ia lehtësoni gjërat aq më i pasigurt do të bëhet fëmija. Një mbrojtje 100%-ëshe nuk egziston.

Këshilla dhe shembuj tjerë mundë të gjeni në: . www.kinder-4.ch

Burimi: <https://www.kindergesundheit-info.de/themen/spielen/alltagstipps/hauptsache>.